

Afatet dhe mënyrat e kthimit të përgjigjeve në lidhje me kërkesat ,ankesat dhe vërejtjet

Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigojë këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet, nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.

Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokolli dhe elektronik për regjistrimin e sinjalizimeve. Njësia përgjegjëse brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës, vendos me akt të ndërmjetëm të arsyetuar për riparimin e pasojave të paligjshme nga akti i hakmarrjes. Në rast të shkeljes së këtij afati, kërkesa e sinjalizuesit paraqitet tek ILDKPKI-ja, që vendos brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës për riparimin e pasojave të paligjshme të aktit të hakmarrjes.

Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së një kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja, njofton me shkrim sinjalizuesin për regjistrimin e pretendimit dhe emrin e personit pranë Njesisë Përgjegjëse të Sinjalizimit, i cili do të ndjekë çështjen. Përmbajtja e regjistrit të posaçëm për këtë qëllim përcaktohet me urdhër të veçantë të Inspektorit të Përgjithshëm.

Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 60/2016. Për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.

Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit

Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe: mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione; mund të konsultohet me dosjen e hetimit; ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij. [17]
[SEP]

Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit është e detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.

Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.

Nëse në përfundim të hetimit administrativ nga Njësia Përgjegjëse të Sinjalizimit rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative, sipas ligjit, Përgjegjësi Njesisë Përgjegjëse të Sinjalizimi sipas rastit, vë në dijeni organin kompetent.